



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
G.J.P "AUTODUSKA STANICA" A. D.
M.P.E "BUS STATION" J. S.
Nr. 02/1004 Data 03.06 2021
No. Date
PRISHTINË/A

Nr./No./Br. 01-1395/21
Data/Date/Datum 03-06-2021
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

MARRËVESHJE

MBI AUTORIZIMIN E INKASIMIT TË PAGESAVE TË FATURAVE TË NPL – "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A., PRISHTINË

E lidhur ndërmjet palëve:

1. **Posta e Kosovës SH.A.** e regjistruar në regjistrin e bizneseve kosovare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë sipas numrit unik identifikues 811285205, me seli në rrugën "28 Nëntori" nr. 4 - Prishtinë, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Xhevdet SMAKIQI, Kryeshef Ekzekutiv i PK Sh.A.

dhe

2. **NPL – "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë**, e regjistruar në regjistrin e bizneseve kosovare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë sipas sipas numrit unik identifikues 811318741 me seli në rrugën "Bill Clinton" pn - Prishtinë, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Luan HOTI, Kryeshef Ekzekutiv,

NDËRSA:

Duke pas parasysh bashkëpunimin e suksesshëm, nevojën për vazhdimin e bashkëpunimit, kushtet dhe premtimet reciproke të parashtruara në këtë marrëveshje palët bien dakord si vijon:

PËR AUTORIZIMIN E INKASIMIT TË PAGESAVE TË FATURAVE TË QIRAVE, PARKINGJEVE, PERONIZIMEVE DHE MARKETINGUT/REKLAMAVE TË NPL – "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A., PRISHTINË

Sot, më datë 30.21. në Prishtinë, bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi në Kosovë, lidhet kjo Marrëveshje, e cila ka për objekt dhënien e autorizimit për inkasimin e pagesave të faturave të qirave, parkingjeve, peronizimeve dhe marketingut/reklamave të NPL – "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë, në sportelet e Postës së Kosovës Sh.A.

NPL – "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë, pajtohet me faktin që midis kompanive tona respektive ka një marrëveshje për ofrimin e shërbimit të inkasimit të pagesave të faturave dhe në bazë të kësaj NPL – "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë i jep autorizim Postës së Kosovës Sh.A. që për klientët e saj ta kryejë shërbimin e pagesave

të faturave të qirave, parkingjeve, peronizimeve dhe marketingut/reklamave NPL – “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. – Prishtinë.

Gjithashtu, NPL – “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. – Prishtinë, është i njohur me faktin që Posta e Kosovës Sh.A. është licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës për Shërbimet Financiare Jo-bankare prej muajit dhjetor të vitit 2013 dhe konform kësaj licence nga BQK-ja, është e autorizuar për kryerjen e aktivitetit të pagesave (shërbimet e pagesave) të parapara sipas paragrafit 2.6 të nenit 94 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare, dhe në këtë rast të ushtrojë veprimtaritë e poshtëshënuara për pagesat:

- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat për parkingun mujor;
- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat për peronizim;
- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat e qirasë për objektet në kuadër të stacionit;
- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat për marketing/reklama.

Neni 1

Shërbimi, kërkesat e shërbimit dhe orari i punës

Në përputhje me të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Kosovë dhe në masën e lejuar prej tyre, Posta e Kosovës Sh.A. do t’iu ofrojë konsumatorëve kryerjen e këtyre llojeve të pagesave të NPL – “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. – Prishtinë Sh.A, përmes sporteleve të zyrave postare:

- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat për parkingun mujor;
- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat për peronizim;
- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat e qirasë për objektet në kuadër të stacionit;
- NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. pagesat për marketing/reklama.

Orari i punës do të jetë çdo ditë pune dhe ditë të javës gjatë së cilave edhe zyrat përkatëse postare punojnë.

Rrjeti i shërbimit të inkasimit për pagesat e faturave do të rritet gradualisht sipas kërkesës dhe pëlqimit të palëve në këtë marrëveshje. Po ashtu sipas kërkesës dhe interesimit të konsumatorëve të palëve do të mund të specifikohen edhe zyra postare të tjera për klientë, sipas marrëveshjes së dakorduar paraprakisht mes palëve në këtë marrëveshje.

Neni 2

Nxitja e shërbimit dhe reklammat (marketing eventual)

Palët në këtë marrëveshje do të bëjnë përpjekje të gjithanshme për të nxitur shërbimin, në mënyrë që të stimulojnë interesin e klientëve dhe ta rrisin besimin e tyre në këtë shërbim, i cili do t’iu ofrohet atyre.

Për këtë qëllim do të mund të përdoren në mënyrë të përshtatshme shenjat dalluese, broshurat, tabelat dhe materialet e tjera të marketingut relevant brenda dhe jashtë lokaleve në zyrat postare të autorizuara për kryerjen e këtij shërbimi. Për këtë qëllim do të mund të përdoren edhe reklammat përmes mjeteve të informimit publik, radio, tv, e të ngjashme. Shpenzimet e tilla të reklamave do të dakordohen në mes palëve në këtë marrëveshje, sipas nevojës me amendamente shtesë kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Pagesat/komisionet e shërbimit

Faturën me shumën të cilën kompania NPL – “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. – Prishtinë ia faturon konsumatorit, Posta e Kosovës e inkason të plotë, ndërsa për shërbimin e vet e ngarkon me komision klientin (konsumatorin) sipas tarifave aktuale të Institucionit Financiar Jo-bankar të PK Sh.A.

Komisioni/provizioni për çdo transaksion - inkasim të pagesës sipas faturës me vlerë deri **10.00 €** (dhjetë euro) është **0.50 €** (zero pikë pesëdhjetë cent), ndërsa për faturat mbi **10.00 €** (dhjetë euro) aplikohet komisioni **1.00 €** (një euro), të cilën obligohet ta paguajë klienti .

Neni 4

Standardet e kryerjes së shërbimit të inkasimit

Të gjitha transaksionet e inkasimit të pagesave të faturave që kryhen nëpër zyrat postare do të procesohen përmes Sistemit të Automatizimit të Sporteve (SASP) dhe palës do t’i jepet dëshmia mbi pagesën e kryer (fletë-transferi).

Shumat e mjeteve, të cilat gjatë ditës grumbullohen nga inkasimi i pagesave të faturave do të deponohen ditën e nesërme në Bankën Ekonomike, e cila menjëherë i përcjell të njëjtat në llogarinë përkatëse bankare të NPL – “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. – Prishtinë, në BQK.

Palët në marrëveshje pajtohen me përdorimin e procedurave standarde të koordinuara me rastin e licencimit lidhur me procedimin e pagesave, sipas standardeve dhe formatit të BQK-së.

Neni 5

Mbajtja e dokumentacionit

Posta e Kosoves do ta ruajë të gjithë dokumentacionin e inkasimit të pagesave në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të shërbimit. Po ashtu afati i ruajtjes së dokumentacionit do të jetë i bazuar në afatet ligjore të ruajtjes sipas ligjeve pozitive.

Neni 6
Ruajtja e sekretit afarist dhe konfidencialiteti

Posta e Kosovës do ta zbatojë në përpikëri të plotë ruajtjen e sekretit afarist dhe konfidencialitetin konform ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse ligjore që e rregullojnë këtë çështje.

Neni 7
Trajnimi

Posta e Kosovës merr përsipër trajnimin eventual të stafit të saj që do të merret me inkasimin e faturave të pagesave të NPL – “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. – Prishtinë. Nëse nevojitet bashkëpunim rreth trajnimit të përbashkët, palët pajtohen se do të bashkëpunojnë në këtë drejtim.

Neni 8
Dispozitat e përgjithshme dhe të fundit

Kjo Marrëveshje shpreh vullnetin e plotë të palëve me qëllim të krijimit të marrëdhënieve reciproke dhe ka për qëllim ofrimin kualitativ të shërbimeve për klientët dhe konsumatorët e shërbimeve.

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese dhe është e vlefshme deri në një afat të pacaktuar. E njëjta mund të shfuqizohet apo ndërpritet nga ana e palëve në çdo kohë, me paralajmërim me shkrim në afat prej 60 ditësh.

Çdo çështje e pa trajtuar në këtë marrëveshje do të rregullohet bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, të cilat rregullojnë këtë lëmi.


Kjo Marrëveshje është e hartuar dhe nënshkruar në kopje të mjaftueshme për nevojat e palëve.

NËNSHKRUHET PËR DHE NË EMËR TË POSTËS SË KOSOVËS SH.A. DHE NPL – “STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A. - PRISHTINË

“Posta e Kosovës” Sh.A.


Xhevdet SMAKICI
Kryeshef Ekzekutiv

NPL – “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. –
Prishtinë


Luan HOTI
Kryeshef Ekzekutiv